



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.542/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.02.2025, merr këtë :

VE N D I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat A.nr.542/2025, dhe A.nr.543/2025 datë 10.02.2025, të parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 10.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuar me numër Anr.542/2025, dhe ankesa Anr.543/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë.

-Në ankesën Anr.542/2025, parashtruesi i ankesës thekson se më datë 09 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Komuna Istog, gjatë monitorimit të ditës së zgjedhjeve, ka identifikuar një fotografi të publikuar në facebook të Arianit Selmanaj, këshilltar komunal në Komunën e Istogut, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, së bashku me kandidatin për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, Shkëmb Manaj, si dhe një numri të konsiderueshëm të njerëzve, gjatë kohës kur është e ndaluar çdo formë e fushatës, konkretisht ditën e zgjedhjeve pas hapjes së Vend Votimit. Kjo fotografi është e shoqëruar me numrin e subjektit politik LDK (124) është bërë me qëllim të promovimit të subjektit politik dhe ndikimin tek votuesit. Konsiderojmë se një veprim i tillë, i kandidatit për deputet të LDK-së, dhe i subjektit politik LDK, bie ndesh me nenin 37 paragrafi 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe Nenin 8 par 1 nën paragrafi

1.1. i Rregullores Zgjedhore NR. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, me çka ka tentuar që në ditën e zgjedhjeve të ndikoj tek votuesit kundërligjshëm.

Parashtruesi i ankesës ka bashkëngjitur si provë linkun e fotografisë si dhe fotografi e publikuar në profilin e facebook : [https:// www.facebook.com/1561857345/posts/10236466100583511/?rdid=H5hHtZZ1LpKEsLsM#](https://www.facebook.com/1561857345/posts/10236466100583511/?rdid=H5hHtZZ1LpKEsLsM#).

-Në ankesën **Anr.543/2025** në të cilën pretendohet më datë 09 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Istog, gjatë monitorimit të ditës së zgjedhjeve, ka vërejtur lëvizje të deputetëve nga radhët e LDK-së, në afërsi të shkollës "Trepça" në Banjë- Istog, konkretisht deputetët Besim Mulaj, dhe Shkëmb Manaj të cilët përveç se shihen në afërsi të shkollës, shihen dhe duke bërë simbolin e "dy gishtërinjve" simbol ky i Lidhjes Demokratike të Kosovës, konsiderojmë se një veprim i tillë bie ndesh me heshtjen zgjedhore në këtë moment, andaj ky veprim përbën shkelje, dhe kandidatët në fjalë kanë rënë ndesh me nenin 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe neni 7 par 2 nën paragrafi 2.9 i Rregullores Zgjedhore NR. 07/2024 për fushatën e zgjedhjeve.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik LDK për rastin **Anr.542/2025** thuhet se se z. Arianit Selmanaj, të cilin ankuesi e konsideron si mbështetës të LDK, me rastin e postimit të tij në rrjetin social facebook nuk përbën asnjë shkelje të nenit 37 paragrafi 2, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ne rastin e mësipërm fotoja e bashkëngjitur është bërë pa përmbajtje të elementeve zgjedhore, apo thirrjeve për votim, pra ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj me provë ose me saktësi kohen e postimit, çka nuk është as binde e as faktike për PZAP, për me tepër në foton e bashkëngjitur ankuesi me ndonjë program special apo specifik ka shtuar numrin e LDK-se në këto zgjedhje dhe dy gishtat lart qe janë simbol i partisë, duke abuzuar kështu me të drejtën e ankesës, sepse postimi real i z. Selmanaj nuk përfshin elemente të tilla.

Në përgjigjen në ankesë **Anr.543/2025** datë 11.02.2025 të subjektit politik LDK thuhet se kandidatet për deputet nga radhët e LDK në afërsi të shkollës "Trepça" në Banjë Istog kanë shkelur nenin 37 paragrafi 1 , nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të LZP, me rastin e kalimit të tyre andejpari nuk përbën kurrfarë shkelje dhe është absurditet logjik e juridik, madje abuzim me të drejtën e ankesës nga ana e subjektit politik LVV, dhe meqë nuk ka asnjë element të shkeljes se heshtjes zgjedhore, pengimit të procesit apo të ngjashme nuk përbën kurrfarë shkelje të LZP. Kurse, pretendimi i bërjes së simbolit me "dy gishtërinj" nuk përbën kurrfarë rëndësie për vendimmarrje nga PZAP, sepse as nuk është thirrje për votim, as slogan zgjedhor, as logo me numër të partisë për zgjedhjet e 9 shkurtit apo të vet kandidatëve, andaj kjo ankese duhet të refuzohet si e pabazuar, theksohet në përgjigje në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në nenin 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit, dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim : **Anr.542/2025**, dhe **Anr.543/2025** të datës 10.02.2025, janë bashkuar, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët **Anr.542/2025**, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kundër subjektit të njëjtë politik Lidhja Demokratike e Kosovës

(LDK), për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e parashtruara të ankesave.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se :

-Ankesat janë të bazuara.

Paneli, pas shikimit shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale nga subjekti politik LVV, në ankesën Anr.542/2025, ku Arianit Selmanaj, këshilltar komunal në Komunën e Istogut, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, së bashku me kandidatin për deputet nga LDK, Shkëmb Manaj, me qëllim të bërjes së fushatës zgjedhore gjatë ditës së votimit ka postuar fotografi në rrjetin social facebook, me numër 124, me qëllim të promovimit të subjektit politik LDK, dhe ndikimit tek votuesit, dhe pretendimet e ankuesit në ankesën Anr.543/2025, se subjekti politik LDK ka bërë veprime të ndaluara para procesit të votimit, konkretisht deputetët Besim Mulaj, dhe Shkëmb Manaj për të cilët pretendohet se përveç se shihen në afërsi të shkollës, shihen dhe duke bërë simbolin e "dy gishtërinjve" simbol ky i Lidhjes Demokratike të Kosovës, erdhi në përfundim se pretendimet e ankuesit në ankesat e tij, se subjekti politik LDK ka bërë veprime të ndaluara para procesit të votimit, konkretisht deputetët Besim Mulaj, dhe Shkëmb Manaj, PZAP-i i vlerëson si të pabazuara dhe të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete, pasi që nga provat e bashkangjitura ankesës nuk vërtetohet se nga subjekti politik LDK është shkelur neni 37 paragrafi 1.1 dhe 1.2 *"Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.1. shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi të votuesit; 1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre"*.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesave lidhur me shkeljet e pretenduara nga ana e subjektit politik në fjalë, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesa nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që parashtruesi i ankesave, në ankesat e tij ka bashkangjitur postime, dhe video për kandidatët në fjalë, mirëpo me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetohen shkeljet e pretenduara, e që sipas vlerësimit të Panelit nuk ka shkelje të heshtjes zgjedhore, dhe nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore të përmendura më lartë, po ashtu me provat e bashkangjitura nga ankuesi në ankesat e parashtruara në ankesa, nuk është vërtetuar koha e saktë e postimit.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesat janë të pabazuara pasi që nga provat e ofruar si dëshmi të cilën parashtruesi i ankesave ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar, dhe koha e saktë e postimit.

Andaj duke u mbështetur në nenin 1 17.3 të LZP-së në të cilin nen në mënyrë decidive thuhet se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa, dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i

ankesave nuk kanë arritur që të vërtetojë pretendimet e theksuara si më lartë me dëshmi të kjarta, dhe bindëse.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke bazuar në nenin 117 par. 3, neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.542/2025 datë 13.02.2025.

Kryesues i Panelit,

Bujar Muzaqi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.